



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN031020220005

Tiranë, më: 07.11.2022

Komisioni 85

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person Juridik: “KALIVIOTI” sh.p.k

Nr. NIPT-i: J64228811C

Adresa e selisë: Vlore, Livadhja, 1 km larg qendrës së fshatit Livadhja, në krahun e djathtë të rrugës për fshatin "Lefter Talo", nr. kadastral 2473, nr.pasurie 0/1,20/2.20/3.20/4 dhe 20/5, godina nr.1, kati i parë

Personi përgjegjës: Vangjel Kalivjoti

Për të zhvilluar projektin “**Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat me shfrytëzim ne qiell të hapur dhe nga guroret Objekti Rrëza e Milesë**”

Aplikimi është bërë referuar ligjitNr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Objekti Rrëza e Milesë, Sopik, Qarku Vlorë, Leja Minerare nr. 717/2

Të dhëna teknike:

Sipërfaqe 0.094 km²

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: • Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ushtrimit të aktivitetit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
- Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e mjedisit, nëse do të ketë përdorim të lëndëve plasëse, përdorimi i tyre të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

- Sugjerojmë që mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të aktivitetit të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve.
- Sa i takon sektorit të biodiversitetit shprehet që aktiviteti duhet t’i përmbahet legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve: Ligjin nr. 9587, date 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar; dhe Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar.

Sugjerojmë që të bëhet rehabilitimi i zonës me mbjellje pemësh;

- Sa i takon sektorit të cilësisë dhe pastërtisë së mjedisit shprehet që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi, Ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosën kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku kërkon të zhvillohet aktiviteti nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet me sugjerime:

- Të bëhet menaxhimi i mirë i mbetjeve sterile dhe dherave që prodhohen gjatë fazës së zbulimit të mineralit gur gëlqeror duke u sistemuar në sheshin e depozitimit të përcaktuar brenda sipërfaqes që kërkohet leja minerare.
- Mbetjet inerte që do të gjenerohen të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- Të evitohet efekti i erozionit.
- Të bëhet sistemimi i dherave në tarracat e shesheve të shkallëve për të gjithë sipërfaqen që do të shfrytëzohet për të krijuar sipërfaqet për mbjellje, shkurresh ose barishtesh të zonës duke përmirësuar dhe peisazhin estetik.
- Mbetjet sterile dhe inerte të ripërdoren për rehabilitimin e zonës së shfrytëzimit dhe për ndërtimin e një sërë rrugësh të brendshme në zonën e karrierës.
- Të përdoret ujë për lagjen e territorit në formë spërkatje për shmangien e pluhurave dhe këto ujëra së bashku me ujërat e shiut të grumbullohen në vaska dekantimi para se të derdhen në kanalet e zonës.
- Të monitorohet niveli i zhurmave sipas Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara".
- Të zbatohet legjislacioni mjedisor në fuqi gjatë shfrytëzimit.
- Territori ku kryhet aktiviteti minerar duhet të rrethohet me tabela paralajmëruese ku të tregohet për punimet që kryhen, rradhën e kryerjes së tyre.
- Të kryhet rehabilitimi përfundimtar i shkallëve të karrierës, shesheve të karrierës, rrugëve jashtë karriere, shesheve të depozitimit të sterileve etj.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye në datën 14.07.2022. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit, dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguroa të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- **Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.**
- **Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 85, datë 07.10.2022, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.106, datë 19.05.2022, "Një ndryshim në Urdhërin nr.75, datë 13.04.2022, për "Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis".**
- **Njoftim për fillim procedure për zgjerimin e lejes nr. 717/1, datë 30.05.2013, me Nr. 5343/1 Prot. datë 165.06.2017, (Ishte 0.048 km², bëhet 0.094 km²)**

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT/Bashkia/Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
- 4.2 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërprisë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.**
- 4.3 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet**

kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.

- 4.4 Aktiviteti të kryhet brenda sipërfaqjes së zonës minerare të miratuar si dhe në bazë të vlefshmërisë së Lejes së Shfrytëzimit.
- 4.5 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëj heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë. Te kete ne vemendje te veacnte referencat kadastrale qe preken nga ushtrimi i aktivitetit.

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.7 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 **Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.20 Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.
- 4.21 Personi përgjegjes teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve/mjedisit në fuqi dhe për zbatimin e tyre.

- 4.22** Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.23** Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.24** Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.25** Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.26 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.**

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	09.05.2023	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	09.05.2023	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	09.05.2023	Çdo 6 muaj

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	09.05.2023	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	09.05.2023	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	09.05.2023	Çdo 6 muaj

- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- Afati i Vlefshmërisë

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Konfirmoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Harta Topografike me koordinatat.

